

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"VIVI MT" SHPK**

Bazuar në vullnetin e ortakëve dhe mbështetur në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, datë 27.10.2011 vendoset si më poshtë:

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia e Shoqërisë.**

**Neni 1:**

**Themelimi, Themeluesit, Emri.**

*Sot më datë 29.06.2022* themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emrin: **"VIVI MT" SHPK.**

Themeluesit e shoqërisë **"VIVI MT" SHPK** janë;

- **Zj.Blerina Kulara**, shtetase SHQIPTARE, e bija e Spiros, e datëlindjes 21.02.1986, lindur në Tiranë, mbajtëse e ID , me nr.I65221069T, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

Të cilët redaktojnë këtë Akt-Themelimi, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

**Neni 2:**

**Objekti i Shoqërisë.**

Ushtrim i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe për llogari të institucionit financiar Jo Bankë AK-INVEST sha. Këmbim Valutor. Ushtrim i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime si agjent, agjenci turistike dhe udhëtimi. Pagesa utilitare. Siguracione. Makina me qera. Agjensi imobiliare. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja e shoqërisë.**



Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar.

#### **Neni 4:**

##### **Selia e shoqërisë**

Rr.Grigor Heba, Nd.45/1, Nr.ap.74, Nr.Pasurie 6/124+5-74, Zonë Kadastrale 8270, Tiranë.

#### **Kreu II**

##### **Kapitali i shoqërisë.**

#### **Neni 5:**

##### **Vlera dhe pagesa e kapitalit të paguar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është si vijon:

Lloji i kontributit është në para në vlerën 100,000 (njëqindmijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë 100,000 (njëqindmijë) lekë;

- **Zj. Blerina Kulara** është zotëruese e 1 (një Kuote) me vlerë 100,000 Lekë (njëqindmijë lekë), që korrespondon në 100 % të Kapitalit të Shoqërisë.

#### **Kreu III**

##### **Administratori i shoqërisë.**

#### **Neni 6:**

##### **Emërimi dhe kohëzgjatja e Administratorit.**

Asambleja e përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjecare (5 vjet), në pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 datë 14.04.2008, i ndryshuar. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.

- *Administrator i kësaj shoqërie është* **Zj.Blerina Kulara**, shtetase SHQIPTARE, e bija e Spiros, e datëlindjes 21.02.1986, lindur në Tiranë, mbajtëse e ID , me nr.I65221069T, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar;

#### **Kreu IV**

##### **Dispozitat Përfundimtare.**

#### **Neni 7:**



Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Ortaku /Ortakët e shoqërisë nuk kufizohen në rritjen e kapitalit të Shoqërisë. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private, midis ortakëve, punonjësve dhe personave të tretë, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit tregtar.

Modalitetet për ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj, do të rregullohen nga Statuti i Shoqërisë dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Tiranë, më datë 29.06.2022

**THEMELUESIT**

zj. Blerina Lulani

